

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i çështjes Avni Sylja, me Bashkëpunëtoren Profesionale Bleta Gashi Rrusta, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.B., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr. 1834/2020 të datës 02.06.2020, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me datë 12.06.2020, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Prokurores së Shtetit Rukije Sheshivari dhe i akuzuari A.B. me datë 12.06.2020 mori dhe shpalli, ndërsa me datë 29.06.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.B., i biri i A. dhe A. e gjinisë M., i lindur më datë ... në fshatin A. Komuna Skenderaj, tani me vendbanim në fshatin K., Komuna Malishevë, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 14.05.2020, rreth orës 16:00, në vend punishte në objektin në ndërtim “O.” të Kompanisë “C...” në lagjen “T.” në Prishtinë, i pandehuri A.B. , pasi që kishte pasur një fjalosje të mëhershme me të dëmtuarin derisa kanë qenë duke punuar në vend punishte, ashtu që me dashje që t’i shkaktojë lëndime trupore e ka goditur në kokë, me një shufër hekuri mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore, ku si pasojë i dëmtuari nga goditja e furishme rrëzohet për toke duke e humbur edhe vetëdijen, nga aty dërgohet në trajtim në QKUK në Prishtinë, i cili pëson plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e laprës së veshit të majtë dhe ndrydhje në indet e buta në regjionin e kokës e të cilat paraqesin lëndime të lehta trupore me pasojë të përkohshme për shëndetin.

- **me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform dispozitave të cituara më lartë dhe neneve 7, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 49 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së e,

G J Y K O N

Të akuzuarin A.B. me Dënim me Kusht duke i vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit, në dënimin e shqiptuar do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 14.05.2020 deri me datë 12.06.2020.

Të pandehurit me aktvendim të veçant i është ndërprerë masa e paraburgimit me datë 12.06.2020.

Obligohet i akuzuari që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të Ekspertizes mjeko – ligjore të paguajë shumën prej 20.00 (njëzetë euro) €, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 25.00 (njëzetë e pesë euro) €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30 (tridhjetë) euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.1834/2020 të datës 02.06.2020, me të cilën ka akuzuar A.B., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 12.06.2020 dhe pas leximit të Aktakuzës nga Prokurori i Shtetit dhe pasi që i akuzuari A.B. është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPK-së, i njëjti ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se pendohet thellësisht për veprën penale të cilën e ka kryer, ka shtuar se rasti që ka ndodhur ka qenë diçka e momentit pas disa problemeve që kishin rreth punëve ndërtimore në kompaninë ku punoj, në një formë kam qenë i provokuar nga pala e dëmtuar dhe është e vërtetë që kam reaguuar dhe nuk kam qenë i vetëdijshëm për pasojat që ka mundur ti shkaktojë, për çka i kërkoj falje të dëmtuarit për rastin që ka ndodhur gjithashtu me të dëmtuarin jemi pajtuar familjarisht dhe premtoi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale.

Mbrojtësi i të pandehurit A.B. – Av. Ali Ajeti ka deklaruar se pas konsultimit të mjaftueshëm me të akuzuarin A.B. dhe pasi i njëjti i ka kuptuar përparsitë dhe privilegjet për pranimin e fajësisë, i njëjti është pajtuar që në këtë fazë të procedurës të bëjë pranimin e fajësisë në të gjitha pikat e aktakuzës, i njëjti edhe në procedurën e mëparshme edhe gjatë kësaj procedure ka shprehë keqardhje për atë që ka ndodhur dhe prap sipas tij është në gjendje në sallë të gjyqimit ti kërkon falje publike të dëmtuarit dhe familjes së tij dhe është në gjendje të përgjigjet në çdo kohë moralisht dhe financiarisht për dëmin e shkaktuar ndaj palës së dëmtuar J.P., po ashtu e njofton gjykatën se pas ndërhyrjes se disa bashkëfshatarëve të A., të njëjtit dhe pas kërkim faljes ndaj familjes së J. e kanë pranuar faljen dhe janë pajtuar në mes veti dhe raportet ndër njerëzore në mes tyre tani janë të mira, andaj mbrojtja ka deklaruar se për faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në fazën e hershme të procedurës fillestare dhe për faktin se e gjithë ngjarja ka ndodhur në afekt dhe A. nuk e ka pasur ndonjë qëllim që të kryejë ndonjë veprë penale pa dashje ka ndodhur rasti dhe fakti se janë pajtuar në mes veti, kërkon nga gjykata që të merren parasysh të gjitha faktet e lartëcekura të merren si rrethana lehtësuese dhe gjithashtu faktin se A. nuk ka qenë i dënuar asnjëherë më parë apo i përballur me gjykatë, i kërkojnë gjykatës që të ketë parasysh këto rrethana dhe të ipet një denim sa më i butë.

Prokurorja e Shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që pranimi i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës si dhe bazë ligjore konform nenit 248 dhe meqenëse i pandehuri pranë gjykatës ka deklaruar se nuk do ta përsëritë më këtë veprë penale, i propozon gjykatës që pranimin e fajësisë ta vlerësojë si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit.

Pasi që gjykata konstatoi që i pandehuri e pranoi në tërësi veprën penale me të cilën është ngarkuar, që i pandehuri i kuptoi natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, që pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë është bërë në konsultim të mjaftueshëm edhe me mbrojtësin e tij, që pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 par.4 të KPRK-së, gjyqtari i vetëm gjykues mori aktvendim me të cilin e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që vlerësoi se ky pranim ishte në përputhje të plotë edhe me provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, e që të gjitha këto në mënyrë të plotë dhe të argumentuar e vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në dispozitën e nenit 248 par.1 të KPRK-së, lidhur me pranimin e fajësisë.

Nga thëniet e vet të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor i cili e pranoi fajësinë u vërtetua se i njëjti me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu edhe nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Ekspertiza mjekoligjore e Dr. N.U. e dt. 29.05.2020, Dokumentacioni mjekësor i lëshuar nga QKUK, Klinika Emergjente në Prishtinë, Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit J.P., dëshmia e dëshmitaria F.Q., Video – incizimet e vendit të ngjarjet. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi gjeti se është penalisht i përgjegjshëm dhe e gjykoi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë në seancë të shqyrtimit fillestar, pendimin e tij lidhur me veprën e kryer, ndaj të njëjtit gjykata nuk gjeti se më parë ka qenë i denuar për ndonjë veprë tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese gjykata gjeti, rrezikshmërin shoqërore të veprës penale, faktin se vepra penale është kryer në ato rrethana ashtu që të dëmtuarit me mjet të fort në pjesë të ndjeshme të kokës saktësisht në regjionin e veshit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, andaj të akuzuarit i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit që i është shkaktuar vlerës së mbrojtur nga kryerja e kësaj vepre penale. Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmën si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, si dhe në shprehjen e gjyqimit shoqëror në raport me veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për

respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së qëndrimit në paraburgim të akuzuarit u mor në pajtim me nenin 79 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata ka vendosur në përputhje me nenin 450 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të Ligjit nr.05/L-036.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil është marrë në bazë të nenit 463 par. 2 të KPPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1008/20 të dt. 29.06.2020

Bashkëpunëtore Profesionale
Bleta Gashi Rrusta

G j y q t a r i
Avni Syla

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate.